

NEWSLETTER

Korrik



**Shkolla po Vjen ...
Me një “Klik”
Bli Online
Kids/Youth
në Albsig**

**Aldo Mahmutaj,
i Riu nga Fieri që la
Emigracionin dhe u
bë Pjesë e KPGJT**

**Stafi i Albsig
në Terren, në Ditët
e të Nxehsit “Ekstrem”
Shpërndajnë Ujë në
Ndihmë të Komunitetit**

**Albsig Mbështet
AmCham Albanian
në Festën e Ditës së
Pavarësisë së Amerikës**

**Andrei Lako,
i Riu Këmbëngulës që po ia Kushton çdo gjë
Profesionit të Inxhinierit të Automobilave**

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Nëse t'u desh një jetë për ta krijuar,
të duhen vetëm **10** minuta
për ta **SIGURUAR.**



PJESË E  KASTRATI GROUP



Albsig Mbështet AmCham Albanian në Festën e Ditës së Pavarësisë së Amerikës.

4 Korriku, Dita e Pavarësisë së Amerikës, është festuar edhe në Tiranë. Dhoma Amerikane ka qenë ajo që ka bërë të mundur festimin e ditës së Pavarësisë së Amerikës me një festë madhështore. Eventu ishte projektuar në mënyrë të tillë që të merrnin pjesë rreth 1.000 të ftuar amerikanë e shqiptarë, të cilët u bashkuan për të festuar një datë që simbolizon lirinë. Një festë tipike amerikane është zhvilluar me rastin e festës së Pavarësisë së Amerikës. Anëtarët e Dhomës Amerikane të Tregtisë, biznese amerikane që operojnë në vend, përfaqësues të Ambasadës Amerikane, qeverisë si dhe organizmave ndërkombëtare u bashkuan për të festuar Ditën e Pavarësisë së Amerikës. Në një ceremoni tipike amerikane ku të gjithë elementët krijonin në ambientet e shkollës Wilson, një festë të vogël amerikane, AmCham ka përkujtuar ditën më të rëndësishme të kombit amerikan.

Në emër të ambasadorit amerikan, ka përshëndetur të gjithë të pranishmit në festë, sekretarja e parë e Ambasadës dhe më pas Presidenti i AmCham, z. Philip Bay. Në Ditën e Pavarësisë së Amerikës janë bashkuar shqiptarë dhe amerikanë, të cilët kanë shijuar në freskinë e kodrave të Liqenit Artificial muzikën live të orkestrës, e cila ka respektuar në fillim të dy himnet kombëtarë e më pas ka sjellë notat muzikore më të njohura nga muzika amerikane. Të ftuarit kanë shijuar jo vetëm ushqimet, por edhe pijet e ndryshme, ku mbizotëronte birra vendase. Festa është konceptuar si një "barbeque amerikane", duke sjellë brenda saj të gjithë elementët tradicional të festës në Amerikë, duke filluar që nga natyra barbeque e festës, lojërat e bejsbollit e deri te kulinaria amerikane e përzgjedhur. Festa kulmoi nën ritmin e muzikës, ushqimit tradicional amerikan e spektaklit të fishekzjarreve. Festimi i kësaj dite të rëndësishme tashmë është bërë traditë për AmCham Albania. Eventu nxori në pah rëndësinë e kësaj dite dhe vlerësoi marrëdhënien me shtetin amerikan. AmCham Albania falenderon në mënyrë të veçantë sponsorët, që bënë të mundur me bujarinë e tyre organizimin e një eventu kaq madhështor.



BLI ONLINE  albsig.al

Sigurimi KASKO



ALBSIG



PJESË E
KASTRATI GROUP



Stafi i Albsig në Terren, në Ditët e të Nxehtit “Ekstrem”, Shpërndajnë Ujë në Ndihmë të Komunitetit.



“Një gjest i vogël por me dashuri të madhe.” Albsig ka në fokus kujdesin më të madh ndaj konsumatorëve, ky është mesazhi sensibilizues që Albsig ka bërë të mundur, që përmes një gjesti të vogël të jetë më pranë konsumatorëve në ditët e nxehta të Korrikut.

Stafi i Albsig është sensibilizuar të ndihmojë sadopak qytetarët në këto ditë të nxehta Korriku duke dhuruar ujë.

“Jemi këtu gjithmonë sepse për ne, prioriteti jeni ju”. Ky ka qenë mesazhi kryesor dhe qëllimi i gjithë eventit të realizuar nga Albsig, për të përballuar sa më lehtë ditët e nxehta të Korrikut. Stafi i Albsig është sensibilizuar dhe ka ndihmuar jo vetëm banorët e zonës, por edhe turistë të huaj kalimtarë në rrugën kryesore, duke i udhëzuar për të përballuar sa më mirë valën e të nxehtit.

Specialistët e Albsig kanë udhëzuar kalimtarët për reduktimin e lëvizjeve në oraret me temperaturat më të larta dhe jo vetëm, por kanë mundur t’u shpjegojnë atyre edhe rëndësinë e sigurimit të shëndetit.

I nxehti "ekstrem" ka prekur thuajse të gjithë Evropën ku dhe për Shqipërinë s'mund të bënte përjashtim. Të gjitha parashikimet dhe të dhënat e sinoptikanëve parashikojnë temperatura deri në 43 gradë celsius, çka e bën edhe më të vështirë lëvizjen për qytetarët, sidomos për grupmoshat e rrezikuara.

Mjekja pranë ISHP, Gentiana Qirjako tha se qytetarët, në veçanti të moshuarit e fëmijët të shmangin lëvizjet e panevojshme në oraret e drekës dhe nëse duhet të dalin, të mbajnë me vete ujë dhe mjete mbrojtëse nga dielli. Një masë për të parandaluar të nxehtin sipas mjekes është freskimi i ambienteve të shtëpisë dhe aplikimi i dushit disa herë në ditë.

Për të moshuarit, mjekët sugjeruan që të mos vërshojnë në plazhe me temperatura të larta, pasi kontakti me ujin mund të bëhet shumë i rrezikshëm, e në disa raste mund të rezultojë deri në fatalitet. I nxehti përvëlues vijon edhe ditën e sotme në vendin tonë!

Kjo situatë vjen si pasojë e të nxehtit Afrikan që ka përfshirë prej disa ditësh jo vetëm vendin tonë, por edhe pjesën më të madhe të Evropës Jugore.

OBSH: Në vitin 2022 rreth 60 mijë persona kanë humbur jetën si pasojë e të nxehtit ekstrem.

Organizata Botërore e Shëndetësisë ka përfshirë në listën e emergjencave shëndetësore ndryshimet klimatike, që po japin jo pak efekt në shëndetin e popullatës globale. Sipas ekspertëve të shëndetësisë botërore, shkaqet kryesore të vdekjeve, sëmundjeve dhe shqetësimeve të lidhura me klimën vijnë nga ekspozimi ndaj ngjarjeve ekstreme të motit gjithnjë e më të shpeshta dhe më intensive, duke përfshirë valët e të nxehtit, zjarret, përmbytjet dhe stuhitë, si dhe thatësitrat.

Valët e të nxehtit në të gjithë Evropën ndikojnë në shëndetin dhe jetesën e miliona njerëzve. Vetëm në vitin 2022, sipas OBSH, 60 mijë persona kanë humbur jetën si pasojë e të nxehtit ekstrem. Parashikimet flasin se deri në 2050 kjo shifër mund të rritet në 120.000 vdekje të lidhura me nxehtësinë çdo vit. Ndryshimet klimatike po rrisin rrezikun e valëve të të nxehtit dhe nxehtësia ekstreme në muajt e verës po bëhet normë, jo përjashtim, deklarojnë ekspertët botërorë.

Temperaturat e larta ndikojnë në shëndetin e shumë njerëzve, veçanërisht të të moshuarve, foshnjave, njerëzve që punojnë në ambient të hapur dhe atyre që janë me sëmundje kronike. Nxehtësia mund të shkaktojë lodhje dhe mund të përkeqësojë gjendjet ekzistuese mjekësore si sëmundjet kardiovaskulare, të frymëmarrjes dhe veshkave ose çrregullimeve mendore.

“Një gjest i vogël por me dashuri të madhe.”

— A. Çoniku.



Shkolla po vjen ... Me një “Klik” Bli Online Kids/Youth në Albsig. Siguroni fëmijët tuaj nga aksidentet dhe shëndeti gjatë periudhës shkollore dhe jo vetëm.

Kanë mbetur pak më shumë se 30 ditë nga fillimi i vitit të ri shkollor, prindërit janë dyndur nëpër dyqane të ndryshme dhe pika shitjesh për të blerë atletet firmato, rrobat dhe më pas dhe artikujt e tjerë mësimorë që ju duhen fëmijëve të tyre. Nga një përlllogaritje e thjeshtë, çdo prind harxhon mesatarisht 20-30 mijë lekë të reja për një fëmijë vetëm me fillimin e vitit shkollor. Nëse kësaj shifre do t'i shtonim edhe kostot e tjera që duhen për të përballuar të gjithë vitin shkollor si dhe për shërbimet shëndetësore, kostoja rezulton disa-fish më e lartë. Përballë kësaj situate, pjesa më e madhe e prindërve shqiptarë e kanë të pamundur të përballojnë kostot financiare. Nga ana tjetër, mentaliteti ynë është i tillë që mendojmë sot për sot edhe pse ëndërrojmë të ardhmen e sigurt!

Nga një vëzhgim i tregut rajonal, rezulton se një qytetar evropian paguan mesatarisht 2154 Euro sigurime për shëndetin në vit. Ndërsa mungesa e kulturës mbi sigurimet ka bërë që qytetarët shqiptarë të paguajnë sigurimet shëndetësore publike të detyruara, nga ana tjetër një numër i madh prindërisht preferojnë të shkojnë në spitalet private. Çdo fëmijë shqiptar shkon në spitale apo qendra shëndetësore mesatarisht 2-3 herë në vit.

Një vizitë tek mjeku kushton 3-6 mijë lekë, në varësi të ekzaminimeve që duhet të bëjë fëmija. Të gjitha këto kosto mund të mbulohen fare lehtë nëse fëmijën e keni të siguruar në një nga kompanitë e sigurimit në vend. Në prag të vitit të ri shkollor, Albsig i vjen në ndihmë çdo familje shqiptare me ofertat dhe produktet e veçanta që ua dedikon fëmijëve dhe të rriturve. Një ndër produktet që është efikas dhe i kërkuar nga konsumatori është dhe Sigurimi Kids/Youth. Paketë sigurimi e cila është ideuar për t'i ardhur në ndihmë çdo familje shqiptare.

Çfarë është SIGURIMI KIDS/YOUTH?

Me rritjen e kostove të kujdesit mjekësor dhe mundësinë e lartë të sëmundjeve të papritura, sigurimi i cilësisë së shëndetit tuaj nuk është diçka që mund të anashkalohet, por një faktor shumë i domosdoshëm për t'u marrë parasysh. Pavarësisht nëse jeni në vitet e para të shkollimit, apo do të filloni universitetin, ekzistojnë plane sigurimi për nxënës dhe studentë. Kjo policë, jo vetëm që do t'ju mbajë të shëndetshëm në ambientet e shkollës dhe do t'ju ndihmojë të kurseni para, por shumica e kolegjeve dhe universiteteve jashtë vendit kërkojnë dëshmi të sigurimit shëndetësor të studentëve.

KIDS/YOUTH



ÇFARË PËRFSHIN KY SIGURIM

- Shpenzimet e trajtimit mjekësor në të gjitha entet shëndetësore;
- Paaftësinë e përhershme të plotë ose të pjesshme sipas kushteve të sigurimit;
- Vdekjen ose zhdukjen e shkaktuar nga aksidenti, etj.

DËMET E MBULUARA

- Helmimi akut
- Mbytja
- Dëmtime të shkaktuara nga sforcime fizike (me përjashtim të hernies)
 - Asfiksia me origjinë jo patologjike
- Mungesa e përvojës apo pakujdesitë, etj.

SIGURIMI BËHET PËR:

- FËMIJËT – sipas këtyre Kushteve të Sigurimit janë të miturit mbi moshën 0-15 vjeç, të cilët frekuentojnë ciklin e arsimit para-universitar, ose të ashtuquajturin arsim të detyrueshëm.
- TË RINJTË – sipas këtyre Kushteve të Sigurimit janë personat madhorë përkatësisht nga mosha (15-25 vjeç) të cilët kryejnë studimet universitare, pasuniversitare, fakultetin e dytë etj.



ALBSIG



**Andrei Lako, i riu këmbëngulës
dhe ambicioz që po ia kushton çdo gjë
profesionit të Inxhinierit të Automobilave**

Një rrëfim për shkollën, pasionin, profesionin dhe punën që sapo ka nisur në Albsig.

Makinat i ka cilësuar si pasionin e jetës. Tashmë pasionin po e kthen në profesion që duket se i ka hapur dyert e para të jetës në rrugën e gjatë të profesionit. “Që kur isha fëmijë ashtu si çdo djalë i kisha shumë pasion makinat. Po ajo që besoj më veçonte nga të tjerët është se unë sa i blija makinat i çmontoja dhe i montoja vetë. Mbaj mend se babai im më ka blerë një makinë të madhe lodër me ingranazhe që kishte shumë butona për ta hapur dhe unë edhe pse isha ende pa i bërë 10 vite e çmontova dhe sërish e montova si duhet. Kisha dhe e kam këtë pasion për automjetet që të mësoj çdo gjë rreth tyre”. Kështu nis tregimin e tij Andrei Lako Studenti i vitit të dytë të KPGJT, në Tiranë. Sapo ka mbushtur të 20-tat dhe sapo ka startuar dhe me profesionin e tij të ëndërruar që në fëmijërinë e hershme. I riu nga Korça ka spikatur në fushën e automobilave.

Ndër grupin e studentëve të KPGJT ai është veçuar si studenti më i mirë i degës së automobilave. Në një intervistë për Newsletter Albsig, Andrei tregon me detaje rrugëtimin e gjatë dhe të rëndësishëm në studimet në KPGJT, i cili u finalizua në fund të vitit të parë më një emërim pune.

Si të lindi idea të përzgjedhësh KPGJT, si u njohët me kolegjin?

Jam ndikuar edhe nga babai im sepse me profesion ishte shofer. Duke mësuar makinën që i vogël, jo vetëm për ta ngarë atë, por edhe për ta rregulluar në disa probleme të vogla isha më shumë i lidhur me këtë pjesë. Më pëlqente shumë montimi dhe çmontimi i makinave.

Unë si një i ri i kthyer nga jashtë dhe i joshur për të ikur sërish doja të zgjidhja një shkollë bashkëkohore. Një shkollë që më hap dyert e jetës, dhe kështu bëra, zgjedha KPGJT, i cili jo vetëm që më përkrahu në rrugën e dijes, por më ndihmoi shumë që të nxirrja në pah të gjithë dhuntitë e veçanta të pasionit tim për makinat.

Jo vetëm kaq, por duke u njohur dhe me programin e veçantë që ka kolegji, dhe me modelin gjerman u joshja nga veçantia që kolegji ka dhe u regjistrova.

Si ka qenë viti i parë i KPGJT për ju?

Me këtë mundësi që mua mu dha dua t’ju bëj thirrje të gjithë bashkëmoshatarëve të mi që të regjistrohen në degët e KPGJT. Edhe pse sapo ka startuar KPGJT është mundësia e artë për çdo të ri shqiptar.

Semestri i parë filloi i qetë, sapo u ambientuam me auditorët dhe me stafin akademik. Ndërsa semestri i dytë ishte shumë interesant dhe me shumë vlera profesionale. Sistemi dual i praktikuar tek ne, marrëdhënia mësim-praktikë ka bërë që gjithësecilin prej nesh ta stimulojë në fushën që kemi përzgjedhur. Lënda Elektronikë, ka qenë dhe është lënda ime e preferuar. Vizitat në kolegjet e tjera dhe në firmat e ndryshme kanë qenë shumë inspiruese për ne. Gërshetimi i praktikës me teorinë në terren ka bërë që gjithësecili prej studentëve të aktivizohet në fushat përkatëse.

Si ju erdhi oferta për punë?

Edhe njëherë ju bëj thirrje gjithë moshatarëve të mi të përzgjedhin KPGJT. Jo vetëm një profilizim në profesion, por dhe një gadishmëri për mundësi punësimi brenda firmave të Kastrati Group. Ku u bëra dhe unë pjesë e stafit të një prej firmave të grupit. Pasi përfundova vitin e parë, edhe pse si studentët e tjerë për të përballuar jetesën në Tiranë isha në punë, por jo në profesionin tim, mu dha mundësia që të bëj një intervistë pranë Shoqërisë së Sigurimeve Albsig.

“Edhe pse në fillim mu duk një hap i pabesueshëm, por unë ja dola.”

Pas intervistës unë u emërova si specialist dëmsh të makinave në Departamentin e Dëmeve në Albsig. Fillimisht jam trajnuar nga inxhinierët me përvojë të Albsig-ut për profilin që kemi përzgjedhur, më pas kam nisur të praktikoj shërbimin me klientët, pritjen e klientëve deri në kompletimin e dosjeve për dëmshpërblim.

Ku e shikon veten pas mbarimit të shkollës?

Meqë puna ime këmbëngulëse në shkollë ma dha mundësinë edhe për punë shpresoj të fuqizohem në pozicionin që më është besuar në Albsig, pjesë e Kastrati Group.

Shpresoj që duke marrë përvojën e duhur në Albsig të jem i aftë për çdo punë që mund të lidhet me profesionin tim. Uroj dhe shpresoj që të rinjtë të zgjedhin KPGJT sepse është mundësia e artë që ata kanë ëndërruar.

Falë KPGJT unë munda të gjej qetësinë dhe mundësinë për një të ardhme të sigurt.



Aldo Mahmutaj, i riu nga Fieri që la emigracionin dhe u bë pjesë e KPGJT

Pasioni që u kthye në profesion. Është historia e një të riu nga Fieri, i cili u kthye nga emigrimi për t'u bërë inxhinier në KPGJT.

"Periudha e Covid-19 ndikoi negativisht tek unë, por sërish jam falenderues sepse ajo periudhë e vështirë më shtyu që unë të kthehesha nga emigrimi dhe të filloj shkollën në KPGJT. Kisha studiuar mundësitë që të jepnin të gjitha universitetet dhe shkollat e larta dhe KPGJT ishte ajo që më joshi më shumë që në ofertat e para të saj. Në fillim të duket e pabesueshme po çdo gjë hap pas hapi po më bëhet realitet", kështu nis e tregon përvojën e tij Aldo Mahmutaj, student i KPGJT.

Ai është tejtejet i përmbushur në çdo hap që ka arritur deri tani edhe pse ka pretendime të shumta për të ardhmen. Është nga ata të rinj që nuk kënaqet me pak. Për këtë u bën thirrje të gjithë të rinjve që të zgjedhin KPGJT sepse është zgjedhja e duhur për të ardhmen e tyre.

Si u bërë pjesë e KPGJT?

Që në moshën 10-vjeçare si pjesa më e madhe e çunave dhe une kisha pasion makinat, por isha bërë profesionist edhe në ngjarjen e saj. Degën e studimit në KPGJT ku unë jam sot e zgjedha edhe për efekt shpejtësie sepse brenda dy viteve unë munda të zë një punë në profesionin tim. Ëndrra mu bë realitet në fund të vitit të parë të shkollës ku unë u emërova në punë në profesionin tim.

Si ka qenë viti i parë i shkollës në KPGJT?

Nisi shumë mirë semestri i parë, por përfundoi edhe më mirë. Kushtet dhe ambientet mësimore me standarde evropiane, pedagogët me eksperiencë në fushat e duhura. Gërshetimi i teorisë me praktikën bënë që ne ta kemi më të lehtë, por edhe më të dashur periudhën mësimore. Një vit mësim i gërshetuar me praktikë ishte shumë frytdhënës për secilin prej nesh edhe për kolegjin, pasi ne jemi viti i parë që do të dalim nga bankat e kësaj shkolle.

Si ishte vijimësia e praktikave mësimore dhe mundësia për punësim?

Kam kryer praktikën profesionale në Albsig dhe jam ndjerë shumë i privilegjuar dhe shumë i përkrahur nga një staf profesionistësh të fushës. Fusha e sigurimeve më është dukur tërheqëse sepse e dija që kjo ishte pjesa që më lidhte më së shumti me pasionin tim për makinat. Gjatë praktikës, mendoj se ajo çfarë ka spikatur fillimisht ka qenë dëshira për të mësuar. Jam i mendimit se njeriu mëson dhe duhet të mësojë gjatë gjithë jetës, duhet të jetë konsistent dhe i disiplinuar.

Si u bërë pjesë e Albsig?

Si çdo student i ardhur në Tiranë edhe unë punoja por jo në profesionin tim. Ishte shumë e vështirë, por punoja që të kisha mundësi financiare për t'ja dalë jetesës në Tiranë. Pas vitit të parë dhe pas praktikës së bërë në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig mua më thirrën për një intervistë pune. Ishte intervista më e mirë që unë kam realizuar për punë. E quaj më të mirën sepse ishte një staf shumë pozitiv dhe ishin njëri-tjetri të kualifikuar që vlerësojnë çdo të ri që ka pasion punën. Aktualisht kam pak ditë që më kanë emëruar si specialist dëmsh në Departamentin e Dëmeve në Shoqërinë e Sigurimeve Albsig. Jam tejte i kënaqur me përkrahjen e stafit. Janë një grup ekspertësh të fushës që na mundësojnë dhe na mësojnë rreth profesionit të specialistit të dëmeve për automjetet.

Ku e shikon veten pas mbarimit të Kolegjit Profesional Gjerman të Teknologjisë?

Lidhja me përvojën gjermane është një ndër risitë që duhet ta shfrytëzojë çdo i ri që dëshiron të ketë një shkollë dhe një profesion të duhur. Me këtë rast dua t'i bëj thirrje çdo të riu që ende nuk ka vendosur të bëhet pjesë e KPGJT. Është kolegji që i vjen në ndihmë çdo të riu në rrugën e gjatë të jetës. Pasi se të nisja mësimin në kolegji e kisha si ide që unë sapo të mbaroja shkollën do të ikja në Gjermani.

“Dyert e fatit” mu hapën dhe unë kam një punë që e kisha ëndërruar dhe tani kam hequr dorë nga emigrimi në Gjermani.

Kam një punë dhe uroj të perfeksionohem në profilin e punës që më është besuar.



☎ +355 (0) 42254770 / 764

✉ info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL